



Të dashur kolegë, partnerë dhe studentë,

Me kënaqësi të veçantë ju prezantojmë edicionin e dytë të Newsletter-it të Zyrës për Marrëdhënie Ndërkombëtare të Kolegjit AAB, një hap i ri në drejtim të transparencës, përfshirjes dhe ndarjes së sukseseve tona me komunitetin tonë të gjerë brenda dhe jashtë vendit. Duke reflektuar mbi misionin tonë për të krijuar ura bashkëpunimi dhe për të mundësuar përvojë transformuese ndërkombëtare, ky newsletter synon të sjellë më afër historitë, iniciativat dhe mundësitë që po formësojnë dimensionin global të AAB-së. Si Prorektore për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Bashkëpunim besoj se ndërkombëtarizimi nuk është thjesht një opsion, por një domosdoshmëri për arsim cilësor dhe të qëndrueshëm. Kjo platformë do të shërbejë si dritare për të ndarë rrugëtimin tonë të përbashkët drejt një institucioni gjithnjë e më të hapur, më bashkëpunues dhe më të pranishëm në hartën akademike ndërkombëtare.

Mirë se na bashkoheni në këtë udhëtim!

SHKËMBIME TË STAFIT AKADEMIK PËRMES ERASMUS+

PROF. ASS. DR. MENTOR LECAJ PJESËMARRËS NË TRAJNIM PROFESIONAL NË UNIVERSITETIN ROMANIAN-AMERICAN NË BUKURESHT

Prof. Ass. Dr. Mentor Lecaj, Dekan i Fakultetit Juridik në Kolegjin AAB dhe profesor i së Drejtës Ndërkombëtare, ka marrë pjesë në një trajnim profesional të mbajtur në Universitetin Romanian American në Bukuresht, Rumani. Ky trajnim u zhvillua në kuadër të një programi intensiv akademik me temën “Përgatitja e studentëve në një ambient ndërkulturor”, dhe kishte për qëllim përmirësimin e qasjeve pedagogjike në mësimdhënie dhe ngritjen e cilësisë në arsimin e lartë ndërkombëtar. Gjatë qëndrimit në Bukuresht, Prof. Lecaj mori pjesë në sesione të shumta trajnuese që trajtonin zhvillimin profesional të stafit akademik dhe integrimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies në ambiente ndërkulturore. Lexo më shumë **këtu**



PROFESORESHAT ARLINDA GASHI DHE GRESA SHAQIRI REALIZUAN VIZITË STUDIMORE NË HOLANDË

Universiteti Radboud në Holandë ka organizuar një kurs intensiv në R dhe Machine Learning, ku morën pjesë dy profesoreshat Arlinda Gashi dhe Gresa Shaqiri. Vizita u realizua në kuadër të bashkëpunimit që kanë Kolegji AAB dhe Universiteti Radboud, me përkrahje nga Erasmus+. Gjatë kësaj vizite Arlinda dhe Gresa patën mundësinë që të angazhohen në ligjërata teorike dhe sesione praktike, duke siguruar njohuri të avancuara në analizën e të dhënave dhe në aplikimin e metodave të kërkimit shkencor. Lexo më shumë **këtu**



PROFESORËT E KOLEGJIT AAB PJESËMARRËS NË TRAJNIM NDËRKULTUROR NË BUKURESHT, PËRMES PROGRAMIT ERASMUS+

Prof. Ass. Dr. Hysen Kasumi, profesor në Fakultetin e Shkencave Sociale në fushën e Pedagogjisë, dhe Prof. Mentor Lecaj, përfaqësuan Kolegjin AAB në një trajnim ndërkulturor të mbajtur në American Romanian University në Bukuresht, Rumani, në kuadër të programit Erasmus+. Në kuadër të këtij trajnimit, profesorët e AAB-së patën gjithashtu takime strategjike me përfaqësues të menaxhmentit të universitetit nikoqir dhe me institucione të tjera partnere nga vende të ndryshme evropiane. Kolegji AAB vazhdon të investojë në ngritjen profesionale të stafit dhe të zgjerojë bashkëpunimet ndërkombëtare në funksion të ofrimit të një arsimi bashkëkohor dhe konkurrues. Lexo më shumë **këtu**



STAFI I KOLEGJIT AAB PJESËMARRËS NË “ERASMUS INTERNATIONAL WEEK” NË RUMANI

Nga data 7 deri më 11 korrik 2025, përfaqësues të Kolegjit AAB morën pjesë në “Erasmus International Week” të mbajtur në Universitetin Aurel Vlaicu në Arad, Rumani. Kolegji u përfaqësua nga Prof. Arbërore Bicaj, Prof. Ganimete Ismajli, si dhe Arta Musollaj dhe Bleonë Brestovci nga Zyra për Projekte.


Gjatë javës, stafi ishte pjesëmarrës në punëtori dhe sesione mbi tema akademike e kulturore, ndërsa prezantuan Kolegjin AAB para një audience ndërkombëtare, ndanë përvoja me kolegë nga vende të ndryshme dhe u angazhuan në ngjarje rrjetëzimi. Lexo më shumë **këtu**



TAKIME NDËRKOMBËTARE ME PARTNERË NDËRKOMBËTAR TË ARSIMIT TË LARTË

KOLEGJI AAB FORCON BASHKËPUNIMIN NDËRKOMBËTAR ME UNIVERSITETIN VISTULA (POLONI)

Kolegji AAB kohët e fundit mbajti një takim strategjik me Universitetin VISTULA, duke u përqendruar në projektet e lëvizshmërisë Erasmus+, iniciativat Horizon dhe klasat virtuale. Pjesëmarrësit përfshinin Zëvendës Rektoren Prof. Venera Lljunji, Zyrtaren e Zhvillimit të Projekteve Prof. Ereza Mehmeti dhe Prof. Mimoza Kamberi nga Kolegji AAB, si dhe Prof. Dr. Davut Han Aslan, Znj. Wiktoria Stundis dhe Prof. Dr. Jasurbek Babae nga Universiteti Vistula. Duke shërbyer mbi 17,000 studentë, Kolegji AAB është lider në bashkëpunimin ndërkombëtar, kërkimin dhe arsimin online inovativ. Mundësitë e bashkëpunimit përfshijnë lëvizshmërinë e stafit KA171, shkëmbimet studentore KA131 dhe projektet Horizon mbi lajmet e rreme dhe dezinformimin, së bashku me programe për ndërtimin e kapaciteteve, punëtori ndërkombëtarë dhe kurse të përbashkëta virtuale. Ky partneritet nxjerr në pah përsosmërinë e Kolegjit AAB në ndërkombëtarizim, mësim të përqendruar te studenti dhe bashkëpunim akademik global, duke përforcuar pozicionin e tij si një qendër për kërkim, inovacion dhe arsim dixhital. Lexo më shumë **këtu**



MBAHET TAKIMI NË MES ZHEJIANG UNIVERSITY INTERNATIONAL BUSINESS SCHOOL – ZIBS (KINË) DHE KOLEGJIT AAB



Me dakordimin e dy palëve u realizua një takim nismëtar në mes të dy institucioneve të arsimit të lartë, ZIBS University nga Kina dhe Kolegjit AAB nga Kosova. Institucionet u përfaqësuan nga Du, Siyuan – Drejtoreshë për Angazhim Global dhe Pranime Ndërkombëtare si dhe Lisa Li – Menaxhere për Angazhim Global. Në anën tjetër Kolegji AAB u përfaqësua nga Prorektorja për Marrëdhënie Ndërkombëtare Prof. Venera Lljunji dhe Prof. Mimoza Kamberi. Takimi kishte për qëllim eksplorimet e mundësive për të vendosur një bashkëpunim reciprok me interes të theksuar në projekte, hulumtime, konferenca shkencore, teknologji, inovacion dhe fusha tjera me interes dy palësh. Të dy institucionet u ndan të kënaqura nga takimi duke u dakorduar se në takimet e radhës do të shpalosin ide fillestare konkrete.

KOLEGJI AAB NXIT BASHKËPUNIMIN AKADEMIK RAJONAL ME UNIVERSITETET SHQIPTARE

Kolegji AAB, institucioni më i madh jopublik i arsimit të lartë në Kosovë, po merr një rol udhëheqës në forcimin e integritit akademik rajonal dhe bashkëpunimit ndërkombëtar kërkimor. Në një takim të kohëve të fundit me akademikë të shquar nga Shqipëria, u ndërmorën hapa të rinj drejt krijimit të një platforme të përbashkët kërkimore dhe inovative në Ballkanin Perëndimor. Delegacionet nga Shqipëria përfshinte përfaqësues nga Universiteti i Durrsit "Aleksandër Mojsiu", dhe CIT Tirana. Diskutimet u përqendruan në ndërtimin e një platforme të përbashkët akademike dhe kërkimore për të lidhur universitetet në të gjithë Ballkanin Perëndimor. Partnerët shqyrtuan mundësitë për projektet Horizon Europe, iniciativat Erasmus+ (Strand 3) dhe bashkëpunimin akademik-industri, me një theks të fortë në arsimin virtual, financimin e qëndrueshëm, botimet e përbashkëta dhe konferencat rajonale. Lexo më shumë [këtu](#)



PPËRVOJAT E SUKSESHME TË STUDENTËVE TË KOLEGJIT AAB PËRMES PROGRAMIT TË SHKËMBIMIT STUDENTOR ERASMUS+

ORGES KASUMI PËRFITUES I BURSËS ERASMUS+ NË UNIVERSITY OF LODZ, POLONI

Si student i Kolegjit AAB kam pasur fatin të jem pjesë e një shkëmbimi studentor në University of Lodz, një universitet me traditë dhe nivel të lartë akademik. Kam ndjekur programin e studimeve në fushën e "Computer Science", ku kam pasur mundësinë të thelloj njohuritë në lëndë përkatëse dhe të angazhohem në projekte praktike që më kanë ndihmuar të zhvilloj aftësi të reja dhe të vlefshme për të ardhmen time profesionale. Lodzi është një qytet i gjallë studentor, i mbushur me studentë Erasmus nga e gjithë bota. Gjatë qëndrimit tim atje, pata fatin të takoj dhe të socializohem me njerëz nga kultura dhe vende të ndryshme si Kina, Singapori, Kazakistani, Italia, Franca, Gjermania dhe shumë të tjera. Kjo ndërveprimtari ndërkulturore më pasuroi si në aspektin personal, ashtu edhe profesional. Organizatat si Erasmus Eye, ESN dhe Erasmus Life Łódź luajtën një rol kyç në ofrimin e aktiviteteve dhe eventeve që e bënë këtë eksperiencë edhe më të veçantë. Brenda kuadrit të fakultetit, hasëm lëndë dhe projekte shumë interesante që na ndihmuan të rrisim njohuritë dhe aftësitë tona.





Kontakti

Adresa:

Rr. Elez Berisha, Nr.56
10000 Prishtinë
Republika e Kosovës

Kontakti i përgjithshëm:

info@aab-edu.net

Zyra Ndërkombëtare dhe e Projekteve:

Emri dhe Mbiemri	Pozita	Email
Venera Llunji	Pro-rektore Zyra për Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Bashkëpunim	venera.llunji@aab-edu.net
Ilirjana Geci	Drejtoreshë në Zyrën për Zhvillim të Projekteve	ilirjana.geci@aab-edu.net
Mimoza Kamberi	Koordinatorë për bashkëpunim dhe shkencë	mimoza.kamberi@aab-edu.net
Erëza Mehmeti	Koordinatorë për zhvillim të projekteve	ereza.mehmeti@aab-edu.net
Jehona Rukovci	Koordinatorë për zhvillim të karrierës	jehona.rukovci@aab-edu.net